



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 689 / prot.  
5

Elbasan, me 17.03.2025

**VENDIM**

Nr 33, datë 17.03.2025

**Për**  
**pagesën e orës mësimore të personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve akademike)**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Senati Akademik në mbledhjen e Tij të datës 17.03.2025

**VENDOSI:**

1. Pagesën e personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve akademike) me 5 fishin e pagesës orare të titullit apo gradës për orët mësimore të zhvilluara.
2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve.
3. Vendimi i Senatit Akademik i dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për procedurat miratimit.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

